



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. _____ Prot.

Tiranë, më _____.____.2023

PROCESVERBAL I MBLEDHJES SË KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR

(Mbledhje e realizuar me video konferencë)

(Mbajtur, më 07.06.2023)

Drejton mbledhjen Zëvendëskryetari i Këshillit të Lartë Gjyqësor, zoti Ilir Rusi.

Mbledhja u zhvillua në ambientet e Këshillit të Lartë Gjyqësor. Filloi në orën 14:37 dhe mbaroi në orën 14:44.

Në mbledhje ishin të pranishëm:

1. *Ilir Rusi* (zëvendëskryetar)
2. *Klodian Kurushi* (anëtare)
3. *Fatmira Luli* (anëtare)
4. *Irena Plaku* (anëtare)
5. *Dritan Hallunaj* (anëtar)
6. *Ridvan Hado* (anëtar)
7. *Alban Toro* (anëtar)
8. *Brikena Ukperaj* (anëtare)
9. *Yllka Rupa* (anëtare)

Shënim: Nuk morën pjesë në mbledhje Kryetarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Naureda Llagami, si dhe anëtarja e Këshillit të Lartë Gjyqësor, znj. Marçela Shehu.

Merrnin pjesë gjithashtu nëpërmjet platformës:

1. *Blerta Ngucaj, Drejtore e Departamentit të Shërbimeve Juridike dhe Marrëdhënieve me Jashtë.*

2. Maela Alicanaj, Këshilltare Ligjore pranë Njësisë Mbështetëse pranë Komisioneve të Përhershme të Këshillit.

3. Staf administrativ i KLGJ-së.

RENDI I DITËS:

1. Shqyrtimi i projektvendimit “Për caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme”, i përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës (relator z. Klodian Kurushi).¹

Çështja e cila është për trajtim, sipas njoftimit të bërë, në rendin e ditës datë 07.06.2023, ora 14:30, lidhet me caktimin e gjyqtarëve për gjykimin e çështjeve gjyqësore të veçanta në gjykata të tjera, të ndryshme nga ajo ku ushtrojnë funksionet në mënyrë të përhershme.

Fjala i jepet relatorit të çështjes, për të relatuar relacionin e përgatitur nga Komisioni i Zhvillimit të Karrierës.

Merr fjalën zoti Kurushi për të vijuar me relatimin e relacionit të përgatitur për caktim gjyqtari në Gjykatën e Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar.

Deri më datë 06.06.2023, pranë KLGJ-së, janë regjistruar për trajtim kërkesa për caktim gjyqtari për gjykimin e çështjes gjyqësore të veçantë, e Zëvendëskryetares së Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar, sipas të dhënave të më poshtme: Bëhet fjalë për një çështje penale, ku objekti i akuzës janë nenet 283/a/2, 283/1, 333/a/2, 334/1, të Kodit Penal, numri i gjyqtarëve që kërkohet të caktohet është 3, numri i kërkesës 1554 dhe numri i çështjes 86. I pandehur në këtë rast është shtetasi {...}. Gjyqtarët Irena Gjoka, Etleva Deda dhe Erjon Bani kanë kryer veprime paraprake; Gjyqtarët Erjon Çela, Atalanta Zeqiraj dhe Flojera Davidhi kanë dhënë vendimin përfundimtar për të pandehurit në procedim të lidhur, për shtetasin {...} etj; Gjyqtarët Flora Hajredinaj, Petrit Çomo dhe Elsa Ulliri kanë dhënë vendimin përfundimtar për të pandehurin në procedim të lidhur, për shtetasin {...}. Trupi gjykues i përbërë nga gjyqtarët Diamela Goxha, Rudina Palloj dhe Esmeralda Xhili ka në gjykim të pandehurin në procedim të lidhur, për shtetasin {...}; Gjyqtari Aurel Arapi ka në gjykim çështjen penale në ngarkim të të pandehuri në procedim të lidhur, për shtetasin {...}; Gjyqtari i seancës paraprake Edvan Veçani ka vendosur dërgimin për gjykim të çështjes me të pandehur shtetasin {...}.

¹ Procesverbali i kësaj çështjeje të rendit të ditës është përmbledhje.

Për nevojat si më lart të Gjykatës së Posaçme të Shkallës së Parë për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, në pamundësi të zbatimit të mekanizmave të skemës së delegimit dhe të transferimit të përkohshëm të gjyqtarit, bëhet i nevojshëm zbatimi i Vendimit të KLGJ-së “Për rregullat dhe procedurën e caktimit të gjyqtarit për gjykimin e një çështje gjyqësore të veçantë, në një gjykatë tjetër, të ndryshme nga ajo ku ushtron funksionin në mënyrë të përhershme”.

Në vijim, propozimet e Komisionit janë si më poshtë:

Gjykata nga duhet të përzgjidhen gjyqtarët që do të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë, të jenë gjykatat e shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm.

Gjyqtarët për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçantë të përzgjidhen me short, ndërmjet atyre të cilët kanë të paktën shtatë vjet përvojë në ushtrimin e profesionit, nga të cilat të paktën pesë vjet si gjyqtar për çështjet penale, si dhe kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar sipas Ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Numri i gjyqtarëve që duhet të caktohen për gjykimin e 1 (një) çështjeje gjyqësore të veçanta, të jetë 3 (tre).

Propozimet vijuese të Komisionit janë si më poshtë:

Në shortimin e çështjes, të përjashtohen nga shorti gjyqtarët që kanë pengesë ligjore, referuar relacionit më sipër. Bashkëlidhur relacionit është edhe lista e gjyqtarëve të shkallës së parë të juridiksionit të përgjithshëm që plotësojnë kriteret për t’iu nënshtruar shortit.

Anëtarët e Këshillit nuk kanë kundërshtime ndaj propozimeve të Komisionit dhe kështu vijohet me hedhjen e shortit elektronik.

Nga shorti elektronik përzgjidhen (referuar tabelës në relacion):

Për çështjen nr. 1, penale (kërkesa nr. 1554), gjyqtarët Albert Meça (relator), Luljeta Kole dhe Gentian Marku (anëtarë).

Mbyllet procedura e shortit dhe në tërësi e gjithë mbledhja plenare.

* * *

(Mbledhja deklarohet e mbyllur)

Për Këshillin e Lartë Gjyqësor